

VENDIME MBI BAZËN E KËRKESAVE TË INSTITUCIONEVE KUSHTETUESE DHE ATYRE PUBLIKE

Vendim nr. 201, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, nenin 29, pika 4 e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Kuvendin e Shqipërisë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 774 prot datë 11.02.2021, në kuadër të verifikimit të figurës, integritetit dhe vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të 4 kandidateve për funksion titullari dhe anëtari bordi drejtues të Institucioneve të Pavarura sipas listës se:
 - a) për znj. V.Gj.S.N., Z. L.B.B., Z. L.F.B. dhe Z.Th.K.G., nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tyre, sipas Nenit 29, pika 2, të Ligjit nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet institucionit të Kuvendit të Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 202, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, e në vijim të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Institucionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 111/2 prot dt 06.01.2021, se nga verifikimet e kryera deri tani për Z. V.P.D., nuk rezulton:

- a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar, nuk figuron në dokumente të ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 203, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, e në vijim të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Institucionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 135/6 prot dt 22.02.2021, se nga verifikimet e kryera deri tani për Z. H.S.B., nuk rezulton:
 - a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar, nuk figuron në dokumente të ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 212, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë subjektin Partia Bindja Demokratike, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 455 prot datë 23.03.2021, (tonën), për verifikimin e cilëve etike, morale dhe profesionale të 3 kandidatëve për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë në zgjedhjet e 25 prillit 2021, sipas listës emërore se:
 - a) Për zotërinjtë 1. A.H.P., 2.A.Dh.M. dhe 3. B.B.Sh., nga verifikimet e kryera deri tani, nuk rezulton të ketë të dhëna në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tyre në kuptim të nenit 29, pika 2, dhe nenit 30 pika 2 të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet subjektit Partia Bindja Demokratike.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 213, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të

Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë subjektin Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 47 prot datë 09.03.2021, për verifikimin e cilëve etike, morale dhe profesionale të 3 kandidatëve për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë në zgjedhjet e 25 prillit 2021, në koalicionin ALEANCA, sipas listës emërore se:
 - a) Zonjat dhe zotërinjtë 1. M.H., 2. S.T. dhe 3. B.B., nuk janë subjekt verifikimi për shkak të moshës së tyre nën 14 vjeç para 2 Korrikut 1991, ose me vitlindje përtej datës 2 korrik 1991 si datë fundore e zbatimit të ligjit 45/2015, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet subjektit Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 214, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë subjektin Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 47 prot datë 09.03.2021, për verifikimin e cilëve etike, morale dhe profesionale të 2 kandidatëve për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë në koalicionin ALEANCA, në zgjedhjet e 25 prillit 2021, sipas listës emërore se:
 - a) Për Z. G.S.S. dhe Znj. I.H.S., nga verifikimet e kryera deri tani, nuk rezulton të ketë të dhëna në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tyre në kuptim të nenit 29, pika

2, dhe nenit 30 pika 2 të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet subjektit Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 217, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, dhe 27 gërma “e”, e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 309 prot datë 21.01.2021, se për Z. C.J.C., nga verifikimet e kryera deri tani:
 - a) rezulton si bashkëpunëtor i ish Sigurimit të Shtetit, sipas Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe më pas i dënuar për akuzat që bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale në kuptim ose të përkufizuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar sipas të cilit **Konsiderohet krim politik** ajo vepër penale që është ndëshkuar nga gjykatat ushtarake në bazë të ligjit nr.21, datë 15.12.1944 "Mbi sabotatorët e Luftës Nacionalçlirimtare", të ligjit nr.41, datë 14.1.1945 "Mbi organizimin e funksionimin e gjykatave ushtarake", të ligjit nr.372, datë 12.12.1946 "Mbi fajet penale kundër popullit e shtetit", të neneve 5 e 6 të ligjit nr.373, datë 12.12.1946 "Mbi ndjekjen e tregtisë së ndaluar, të spekulimit dhe të sabotimit ekonomik", si dhe të dënuarit sipas të gjithë neneve të kapitullit "Krime kundër shtetit" dhe për moskallëzim e përkrahje të këtyre krimeve, sipas Kodit Penal të viteve 1952 e 1977, vepra penale që lidhen me fushën e veprimit të ligjit nr. 45/2015, sipas nenit 2 të tij.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Presidentit të RSH-së.
- 3.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 218, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Institucionin e Bashkisë Libohovë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 300/1 prot datë 17.03.2021, “Kërkesë për informacion”, në kuadër të dekorimit të shtetasit, se për Prof. K.M.B., nga verifikimet e kryera deri tani:
 - a) nuk figuron të ketë materiale në emër të tij, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Libohovë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 219, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, dhe 27 gërma “e”, e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për informacionin që

kërkohet me shkresën nr. 1018 prot datë 17.03.2021, se për Z. D.I.T., nga verifikimet e kryera deri tani:

- a) nuk rezulton të ketë të dhëna në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet institucionit të Presidentit të RSH-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 220, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, dhe 27 gërma “e”, e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 315 prot datë 21.01.2021, se për Z. T.Z.B., nga verifikimet e kryera deri tani:
 - a) rezulton të ketë të dhëna në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, si i dënuar për fajin e bashkëpunimit me diversantët dhe agjentët e zbulimit jugosllav duke kryer shërbimin e ndërlydhësit i ka dhënë informata furnizime strehime, ka dhënë informata me karakter ushtarak se ku ishin vendosur repartet ushtarake, informacion i kërkuar nga qeveria Jugosllave e të dhëna të tjera, vepra penale të parashikuara nga neni 3 dhe 14 i ligjit 372 datë 12.12.1946 "Mbi fajet penale kundër popullit e shtetit", të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale të përkufizuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar dhe hyjnë në fushën e veprimit të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar .

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Presidentit të RSH-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 221, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, dhe 27 gërma "e", e vijues të ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "*Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*", Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 242 prot. datë 07.04.2021, në kuadër të verifikimit të figurës, integritetit dhe vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të 4 kandidateve për Anëtar të Asamblesë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ku rezulton se:
 - a) për 1. Znj. K.V.S.(B.), 2. Z. F. S. S. 3.Z. A.I.B., dhe 4. Z.G.R.H., nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tyre, sipas Nenit 29, pika 2, të Ligjit nr.45/2015, "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*" i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 222, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, dhe 27 gërma "e", e vijues të ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "*Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*", Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish -

Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Z. V. Dh. M., në cilësinë e kandidatit për deputet të Kuvendit të Shqipërisë për subjektin politik Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane, (A.B.D.E.), për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 403 prot datë 12.03.2021, (tonën), për verifikimin e cilëve etike, morale dhe profesionale se:
 - a) nga verifikimet e kryera deri tani, nuk rezulton të ketë të dhëna në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tij në kuptim të nenit 29, pika 2, dhe nenit 30 pika 1 dhe 2 të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet subjektit politik Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane, (A.B.D.E.).
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 223, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26, dhe 27 gërma “e”, e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Z. Z. B., në cilësinë e kryetarit të subjektit politik Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 438 prot datë 18.03.2021, (tonën), për verifikimin e cilëve etike, morale dhe profesionale se:
 - a) nga verifikimet e kryera deri tani, nuk rezulton të ketë të dhëna në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tij në kuptim të nenit 29, pika 2, dhe nenit 30 të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet kërkuessit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 242, datë 31.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë Institucionin e Këshillit të Lartë i Prokurorisë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 460 prot. datë 28.01.2021, “Kërkesë” për verifikimin e pastërtisë së figurës, të kandidatit për pozicion drejtuesi në Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, se:
 - a) nga verifikimet e kryera deri tani, rezulton se shtetasi, L.D., bazuar në ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 49 pika 2 shkronja “a” në lidhje me nenin 28 gërma “ë”, sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar,
 - i. Nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizën;
 - ii. Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit.
 - iii. Figuron në 8 (tetë) dosje hetimore gjyqësore (penale) të arshivuara në Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të administruara nga Autoriteti, në detyrën e Prokurorit Gjyqësor të çështjeve të sipërcituara në rrethin e Kukësit, në vitet 1984 deri 1987. Procesi hetimor për çështjet e sipërcituara ka filluar nga strukturat e ish Sigurimit të Shtetit për akuzat, Tradhti ndaj atdheut në formën e arratisjes, Agjitacion e propagandë kundër shtetit, e më pas ka vijuar procesi gjyqësor ku Z. L.D. figuron me detyrën e prokurorit. Veprat penale të parashikuara nga nenet 47 “g” dhe neni 55/1 i Kodit Penal, në Kreun, “Krime kundër shtetit”, bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale të përkufizuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar dhe hyjnë në fushën e veprimit të

ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet institucionit të Këshillit të Lartë i Prokurorisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

**VENDIME PËR PERSONA TË PREKUR, PALË TË TRETA, TË AFËRM
TË TË VDEKURVE APO TË ZHDUKURVE, BASHKËPUNËTORËVE
APO TË FAVORIZUARVE NGA ISH-SIGURIMI I SHTETIT**

Vendimi nr. 197, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20 e 23 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen D. S. për sa kërkohet në shkresën nr. 1400 prot., dt. 22.12.2020, që mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, ka dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit për shtetasi Sh. S.,
 - a) Dosje formulare nr. 105 Kategoria 2-B me 159 (njëqind e pesëdhjete e nëntë) faqe të skanuara dhe të anonimizuara , të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit për subjektin Sh. S.
2. T’i jepet shtetasit D. S. dokumentacioni dublikatë që përmbajnë dosjet e mësipërme në trajtë CD.
3. Të informojë shtetasin D. S. se ekzistojnë dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit, për njohjen e të cilave nga ana e trashëgimtarëve ligjorë ka pengesë ligjore, në bazë të nenin 23 të Ligjit 45/2015.
4. Ky vendim është i ankueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 198, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin H. Q., për sa kërkohet në shkresën nr. 1172 prot, datë 22.10.2020, ku mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, për H. Q. ka dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit si më poshtë:
 - a) Dosje Hetimore Gjyqësore Nr. 1498, e përbërë në total nga 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) faqe të skanuara, të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin H. Q.
2. T'i jepet shtetasit H. Q. dokumentacioni dublikatë që përmban dosja e sipër cituar, në trajtë CD.
3. Ky vendim është i ankimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 199, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin A. H., për sa kërkohet në shkresën nr. 16 prot, datë 08.01.2021, ku mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, për G. H., ka dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit si më poshtë:
 - a) Dosja Hetimore-Gjyqësore nr. 1472 e përbërë në total nga 782 (shtatëqind e tetëdhjetë e dy) faqe të dixhitalizuara, të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin G. H.
 - b) Dosja Hetimore-Gjyqësore nr. 5484 e përbërë në total nga 704 (shtatëqind e katër) faqe të dixhitalizuara, të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin G. H.
 - c) Dosje Formulare, kategoria 2A, nr. 3559, e përbërë në total nga 109 (njëqind e nëntë) faqe të dixhitalizuara, të anonimizuara të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin G. H.
 - d) Dosja Hetimore-Gjyqësore nr. 40 e përbërë në total nga 128 (njëqind e njëzet e tetë) faqe

të dixhitalizuara, të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin G. H.

2. T'i jepet shtetasit A. H., dokumentacioni dublikatë që përmbajnë dosjet e sipër cituara, në trajtë CD.
3. Ky vendim është i ankimeshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 200, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Plotësimin e vendimit nr. nr.680 datë 26.12.2020 të Autoritetit, bazuar në gjetjen e dokumenteve të tjera për shtetasin M. B., me dokumentacionin e përgatitur për të nga ish-Sigurimi i Shtetit në dosjet më poshtë:
 - a) Dosja nr. 978, “Problemi i centralizuar “Gorilla”, fashikulli I, i përbërë në total nga 39 (tridhjetë e nëntë) faqe të skanuara, të anonimizuara dhe të hedhura në format CD që gjenden në arkivat e Autoritetit për subjektin M. B.
 - b) Dosja nr. 978, “Problemi i centralizuar “Gorilla”, fashikulli II, i përbërë në total nga 50 (pesëdhjetë) faqe të skanuara, të të anonimizuara dhe të hedhura në format CD që gjenden në arkivat e Autoritetit për subjektin M. B.

- c) Dosja nr. 978, “Problemi i centralizuar “Gorilla”, fashikulli III, i përbërë në total nga 56 (pesëdhjetë e gjashtë) faqe të skanuara, të të anonimizuara dhe të hedhura në format CD që gjenden në arkivat e Autoritetit për subjektin M. B.
 - d) Dosja nr. 978, “Problemi i centralizuar “Gorilla”, fashikulli IV, i përbërë në total nga 32 (tridhjetë e dy) faqe të skanuara, të të anonimizuara dhe të hedhura në format CD që gjenden në arkivat e Autoritetit për subjektin M. B.
 - e) Dosja nr. 978, “Problemi i centralizuar “Gorilla”, fashikulli V, i përbërë në total nga 64 (gjashtëdhjetë e katër) faqe të skanuara, të të anonimizuara dhe të hedhura në format CD që gjenden në arkivat e Autoritetit për subjektin M. B.
2. T’i jepet shtetasit M. B., nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor z. I. H., dokumentacioni dublikatë që përmbajnë dosjet e sipër cituara, në trajtë CD.
 3. Ky vendim është i ankueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 224, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin B. P., për sa kërkohet në shkresën nr. 487 prot., datë 29.03.2021, se mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente të krijuara në emrin e tij në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 225, datë 17.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin N. D., për sa kërkohet në shkresën nr. 47 prot., datë 15.01.2021, se mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente të krijuara në emrin e tij në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 231, datë 25.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin L. G., për sa kërkohet në shkresën nr. 343 prot, datë 01.03.2021, ku mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, për Dh. G. ka dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit si më poshtë:
 - a) Dosje Hetimore Gjyqësore nr. 2145, e përbërë në total nga 1000 (një mijë) faqe të skanuara, të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin Dh. G.
 - b) Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Përpunimi nr. 304 , Kategoria 2B, e përbërë në total nga 170 (njëqind e shtatëdhjetë) faqe të skanuara dhe të anonimizuara, të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin Dh. G.
2. T’i jepet shtetasit L. G. dokumentacioni dublikatë që përmban dosja e sipër cituar, në trajtë CD.

3. Ky vendim është i ankimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 232, datë 25.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen Sh. Zh., për sa kërkohet në shkresën nr. 478 prot, datë 25.03.2021, që mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, nuk ekzistojnë të dhëna që i ndjeri Z. Zh. ka qenë ndonjëherë i survejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 233, datë 25.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen E. Gj., për sa kërkohet në shkresën nr. 481 prot, datë 26.03.2021, që mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, nuk ekzistojnë të dhëna që i ndjeri P. Gj.,

të ketë qenë ndonjëherë i survejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 237, datë 25.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin A. M. për sa kërkohet në shkresën nr. 507 prot., datë 01.04.2021, që mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, nuk ekzistojnë të dhëna që i ndjeri B. M., të ketë qenë ndonjëherë i survejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 238, datë 25.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin A. G., për sa kërkohet në shkresën nr. 465 prot., datë 24.03.2021, se mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani nuk ekzistojnë të dhëna që ai të ketë qenë ndonjëherë i survejuar apo të ketë dokumente të krijuara në emrin e tij në arkivat e ish-

Sigurimit të Shtetit.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 239, datë 25.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 1, 3, 4, 5, 6, 19 e 22 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen Ç. R. (B.) për sa kërkohet në shkresën nr. 518 prot., datë 06.04.2021, që mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, ka dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit për shtetasen Q. B., si më poshtë:
 - a) Dosje Hetimore Gjyqësore nr. 2344, e përbërë nga 751 (shtatëqind e pesëdhjetë e një) faqe, të skanuara, të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin Q. B. dhe D. M.
2. T’i jepet shtetasës Ç. B. dokumentacioni dublikatë që përmbajnë dosja e mësipërme në trajtë CD.
3. Ky vendim është i ankimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 241, datë 25.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 22, 23 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të vërë në dispozicion të shtetasit F. F., për sa kërkohet në shkresën nr. 948 prot, datë 08.09.2020, dokumentacionin e përgatitur për të nga ish-Sigurimi i Shtetit si më poshtë:

- a) Nga fondi “Drejtoria e Zbulimit Politik, dosje personale, kategoria: informator, pseudonimi “Lisi”, e përbërë në total nga 103 (njëqind e tre) faqe, të fotokopjuara dhe të anonimizuara që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin F. F.
2. T’i jepet shtetasit F. F. dokumentacioni dublikatë që përmbajnë dosjet e sipër cituara, në trajtë fotokopje.
3. Ky vendim është i ankimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 243, datë 31.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin P. D., për sa kërkohet në shkresën nr. 133 prot, datë 25.01.2021, ku mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, për Y. D., ka dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit si më poshtë:
 - a) Dosje Hetimore Gjyqësore nr. 2505, e përbërë në total nga 217 (dyqind e shtatëmbëdhjetë) faqe të skanuara, të hedhura në format CD që gjenden në arkivat e Autoritetit për subjektin Y. D.
 - b) Fondi, Dega e Punëve të Brendshme Berat, regjistër përpunimi Model K.1, Nr. 14, fleta nr 1, konkretisht me numër rendor 219, që gjenden në arkivat e Autoritetit për subjektin Y. D.
2. T’i jepet shtetasit P. D. dokumentacioni dublikatë që përmban dosja e sipër cituar, në trajtë CD.
3. Ky vendim është i ankueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendimi nr. 244, datë 31.05.2021 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20 e 23 vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin K. L., për sa kërkohet në shkresën nr. 37 prot., datë 13.01.2021, ku mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, për Xh. L., ka dokumente në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit si më poshtë:
